



Tirana - La Fiera del libro dedicata a Girolamo De Rada (in translation)

13 November 2014

Al via da oggi la 17° Fiera del Libro di Tirana, in programma fino al 16 novembre presso il Palazzo dei Congressi. La Fiera, alla quale parteciperà anche l'Istituto italiano di cultura di Tirana, è dedicata quest'anno a Girolamo De Rada, figura centrale della letteratura e della cultura arbëreshe dell'Ottocento, in occasione della ricorrenza del Bicentenario della sua nascita. Proprio a De Rada l'lic dedicherà quindi un omaggio attraverso varie iniziative che comprenderanno una conferenza di Francesco Altimari (Università della Calabria) e Matteo Mandalà (Università di Palermo), prevista per domani alle 13 presso la sala Ovale del Palazzo dei Congressi, incentrata sul ruolo culturale di Napoli nel processo di costruzione dell'identità albanese. Seguirà poi, il 14 novembre alle 10, presso lo stand dell'lic, la presentazione della ristampa anastatica della rivista "Albanese d'Italia" di De Rada, pubblicata dalla casa editrice Rubbettino con il sostegno della Fondazione Solano e dell'Ambasciata d'Italia a Tirana.

Girolamo De Rada, figura centrale della letteratura e della cultura arbëreshe dell'Ottocento

Sempre all'interno dello stand dell'lic saranno esposte le riproduzioni delle opere del pittore arbëresh Franco Azzinari, ispirate ai paesaggi deradiani e al poema "Canti di Milosao". Sarà inoltre presentato un video, realizzato dall'Università della Calabria, sulla vita di De Rada interpretata artisticamente da Shpend Bengu. Lo stand dell'Istituto ospiterà inoltre le presentazioni di alcuni libri: venerdì 14 novembre, alle 18, Elio Miracco (Università La Sapienza) presenterà "Prometeo in Albania" di Mauro Geraci e "Il visionario alato e la donna proibita" di Visar Zhiti, pubblicati dalla casa editrice Rubbettino che sarà ospite presso lo stand. Sabato 15 novembre alle 18, infine, Antonio Caiazza, scrittore e giornalista, presenterà la sua seconda opera dedicata all'Albania, "La notte dei vinti", pubblicato dalla casa editrice Nutrimenti. Il libro ricostruisce, attraverso documenti d'archivio e fiction, la tragica fine di Beqir Balluku, ministro della Difesa accusato di alto tradimento da Enver Hoxha.

Approfondimenti

[Istituto di cultura a Tirana](#)

[La rete degli Istituti Italiani di Cultura](#)

[Big Italy Focus](#)



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS

**De Rada 'kthehet' te dheu mëmë me veprën monumentale.
Botohet vepra e plotë e komentuar e autorit, një
bashkëpunim mes Shqipërisë, Kosovës dhe Italisë**
2014-11-13 15:20:00



Vepra e mbështetur nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë, Ministria e Kulturës e Kosovës, Universiteti i Kalabrisë dhe Fondacioni "Francesco Solano" është përgatitur nën drejtimin e prof. Francesco Altimari-t e prof. Matteo Mandala, me bashkëpunimin e Vincenzo Belmonte-s dhe Fiorela de Rosa.

Në datën 12 nëntor 2014, në kuadër të 200-vjetorit të lindjes së poetit Jeronim De Rada dhe vitit të DeRadian, [Ministria e Kulturës](#) përuroi në [Akademinë e Shkencave](#) veprën e plotë të tij në gjashtë volume, duke ruajtur fytyrën autentike të veprës.

Vepra e mbështetur nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë, [Ministria e Kulturës e Kosovës](#), Universiteti i Kalabrisë dhe Fondacioni "Francesco Solano" është përgatitur nën drejtimin e prof. Francesco Altimari-t e prof. Matteo Mandala, me bashkëpunimin e Vincenzo Belmonte-s dhe Fiorela de Rosa.

"Ai shkoi..me hijen e shtëpisë në zemër" thotë De Rada, dhe Jeronimi kthehet falë gjithë shqiptarëve në Shqipëri, Kosovë dhe Itali. Sot një vit më parë me Profesor Francesco Altimari dhe Profesor Matteo Mandala nga Universiteti i Kalabrisë na ngazëlleu ideja se monumenti më i vyer që mund të ngrinin në 200- vjetorin e lindjes së De Radës ishte botimi i plotë i veprës letrare të shkrimtarit tonë mbarëkombetar, Jeronim De Rada. E nisëm kalendarin e këtij viti nën shenjën e De Radës, me aktivitetet studentore, e kulmuam sot me promovimin e gjerdanit të gjashtë veprave, falë punës së profesorëve dhe përkthyesit e studiuesit, Gëzim Gurga. Kalendari do të vazhdojë me gjimnazistët dhe Milosaon e vitit 2014. Ministria e Kulturës botoi në 200 vjetorin e lindjes së autorit të Milosaos tirazhin e plotë të veprave letrare, që do t'u dhurohen bibliotekave shkencore dhe universitare të vendit, për lexuesit e të gjitha moshave. Filluam sot me Akademinë e Shkencave dhe Fakultetin e Histori-Filologjisë. Ky projekt i përbashkët me Ministrinë e Kulturës së Kosovës do të vazhdojë edhe në Prishtinë si gjerdan i vyer i kombit"- u shpreh Ministria e Kulturës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro.

Në fjalën e tij të hapjes Prof. Jorgo Bulo e ka quajtur këtë botim një ngjarje të vërtetë kulturore. Me këtë botim, De Rada "kthehet" te dheu mëmë, jo me një monument prej bronzi, që për fat të keq na mungon edhe sot, por me veprën monumentale poetike të këtij rapsodi gjenial të kombit, që me këtë vepër vuri themelet e letërsisë kombëtare të shqiptarëve. Themelimi i letërsisë kombëtare, vepër njëkohësisht kulturore dhe kombëtare, përqendrohet te dy burra: De Rada në Itali dhe Naimi Frashëri në vendin mëmë, thotë profesor Çabej. "Ka qenë kjo një nga arsytet që De Rada të jetë një autor i studiuar dhe i botuar jo pak pas luftës këtu, në Kosovë dhe tek arbëreshët, por asnjëherë integralisht në këto përmasa dhe me këtë nivel të saktësisë, autenticitetit dhe interpretimit filologjik të tekstit", tha prof. Bulo.

Një nga përgatitësit e veprës së De Radës prof. Francesco Altimari vlerësoi mbështetjen e Ministres së Kulturës Znj. Kumbaro të cilës i

njohu meritën e mbështetjes së nismave të shumta që u zhvilluan gjatë këtij viti jubilar. Botimi i veprës letrare të De Radës përfaqëson pikën më të lartë dhe rezultatin më të dukshëm të angazhimit të gjithanshëm të këtij viti, që Ministrja Kumbaro e pagëzoi zyrtarisht si “Viti Deradian” duke përfshirë në të studiues e institucione të të gjitha trevave shqiptare, në atdhe dhe në diasporë (Itali, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni) për të kremtuar denjësisht 200 vjetorin e lindjes së Poetit të Madh. Prof. Francesco Altimari vlerësoi dhe punën e Z. Gëzim Gurga që përktheu në shqip pjesët italisht të çdo vëllimi.

Ministrja e Kulturës Znj. Mirela Kumbaro dhuroi veprën e plotë të De Radës, përfaqësueses së Bibliotekës së Akademisë së Shkencave znj. Floresha Dado dhe për Bibliotekën e Fakultetit Histori- Filologji, Shefes së Katedrës Znj. Dhurata Shehri.

Botimi i De Radës është shoqëruar në secilin volum të tij dhe me logo-n fituese të konkursit të shpallur nga Ministria e Kulturës me rastin e 200-vjetorit të tij të lindjes.

Ekzemplarët e veprës së poetit arbëresh Jeronim De Rada do t’iu dhurohen bibliotekave shkencore dhe universitare në mbarë vendin.



Fiera del Libro Di Tirana 12 – 16 novembre 2014

GLI APPUNTAMENTI DEDICATI A GIROLAMO DE RADA

Giovedì 13 novembre, ore 13

Conferenza dei Professori Francesco Altimari e Matteo Mandalà

Il ruolo culturale di Napoli nel processo di costruzione dell'identità albanese

Sala Ovale del Palazzo dei Congressi

ore 18

I Professori Francesco Altimari e Matteo Mandalà presentano l'*opera omnia* di

Girolamo De Rada pubblicata dalla casa editrice Rubbettino

Stand Istituto Italiano di Cultura

Venerdì 14 novembre, ore 10

Presentazione della ristampa anastatica della rivista *L'Albanese d'Italia* di De

Rada, pubblicata dalla casa editrice Rubbettino

con il sostegno di Fondazione Solano e Ambasciata d'Italia.

Stand Istituto Italiano di Cultura

Sabato 15 novembre, ore 11

L'Ambasciatore d'Italia S.E. Massimo Gaiani consegnerà il premio intitolato a

Girolamo De Rada offerto dall'Associazione degli Editori Albanesi e

dall'Istituto Italiano di Cultura di Tirana